



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:191632
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06228647

Pml.nr.564/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasim, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit A. C., me vendbanim në rrugën "...", në M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri - Departamenti i përgjithshëm P.nr.302/2023 të datës 02.04.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i përgjithshëm PA1.nr.813/2024 të datës 23.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25 shtator 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit A. C., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.831/2024 i datës 23.07.2024 dhe çështja i kthehet kësaj gjykate në rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.302/2023 e datës 02.04.2024, të dënuarin A. C., e ka shpallur fajtor për *veprën*

penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së. Për pikën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1500 (njëmijepesëqind) €, i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të zëvendësohet me 20 (njëzet) €. Ndërsa për pikën II të dispozitivit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite. Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i armës TT 7.62 mm., me numër serik ..., ngjyrë e zezë, një karikator me pesë fishek, një gëzhjojë dhe tre fishekë tjerë. I dënuari është obliguar që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100 (njëqind) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PANr.813/2024 e datës 23.07.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A. C., avokati Agim Lushta nga M., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale nga neni 384 par.1 të KPPK-së dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale e ku shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj në tersi si të bazuar kërkesën, t'i anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.329/2024 e datës 23.09.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit A. C., av. Agim Lushta, të aprovohet si e bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP-së, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e është e bazuar.

Në kërkesën e tij mbrojtësi i të dënuarit, thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të kodit të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënpar.1.3 e par.2, nënpar.2.1 të KPP-së, ngase as i dënuari dhe as pala mbrojtëse nuk janë njoftuar për datën dhe kohën e mbajtjes së seancës në shkallë të dytë, si dhe nëse shikohet dispozitivi i aktgjykimit, ku në të flitet vetëm për ankesën e prokurorisë e jo edhe të mbrojtësit të të dënuarit, pra në fakt me aktgjykimin e shkallës së dytë fare nuk është shqyrtuar ankesa e tij. Po ashtu konsideron se nuk është zbatuar drejt dispozita e nenit 398 par.3 i KPP-së, ku sipas secilës dispozitë Gjykata e Apelit duhet të vendos për të gjitha ankesat kundër një aktgjykimi me një vendim, pra gjykata e shkallës së dytë duke mos e zbatuar drejt këtë dispozitë e cila ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke mos u lëshuar në pretendime tjera të theksuara në kërkesë, pretendimi i mbrojtësit të dënuarit për mos shqyrtimin e ankesës së mbrojtësit të të dënuarit del të jetë pretendim i bazuar, meqë gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 401 të KPP-së, përkatësisht nuk ka shqyrtuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit, për më tepër, në dispozitivin e aktgjykimit refuzon ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, edhe pse nga shkresat e lëndës del se prokuroria nuk ka paraqitur ankesë, pra me këtë rast është bërë shkelje e nenit 384 par.2, nënpar.2.7 të KPP-së.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim dhe pas kësaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje penalo juridike.

Nga këto arsye, kjo gjykatë konform nenit 438 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.564/2024, më 25 shtator 2024

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi